



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 20 dhjetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1077_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafin 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014 për shoqërinë "Matkos Group" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpcës;
- Vendimin V_864_2016 të datës 25 nëntor 2016 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014, lëshuar shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpcës,
- Vendimin V_932_2018 të datës 29 mars 2018 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014, lëshuar shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpcës,
- Kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014 edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpcës, të datë 02.11.2018 nr. prot. 208/18 të shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., me adresë rruga "Veternik" 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K. dhe **ZGJATET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014, për ndërtimin e Hidrocentralin HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpcës, edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, gjegjësisht deri me **11 nëntor 2019 për përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit.**



Arsyetim

- ZRRE me datë 29.03.2013 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, për katër (4) njësi gjeneruese, HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 2.47 MW, HC Bitinje 2.1 MW, HC Vica 2.5 MW dhe HC Brod 2.5 MW, të gjitha në Komunën e Shtërpçës.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k.ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_541_2013 me datë 28 qershor 2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 19.06.2014 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim Final për HC Bitinje dhe HC Vica të bashkuar në një Hidrocentral me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, në lokacionin “Drekoc”, në Lumin Lepenc ZK Drekoc, Komuna e Shtërpçës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 11.11.2014 ka vendosur që shoqërisë “Matkos Group” Sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi Final V_660_2014 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin Drekoc, ZK Drekoc Komuna e Shtërpçës.
- ZRRE me datë 10.11.2016 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, **për vazhdimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 11 nëntor 2017.**
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 25 nëntor 2016, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., dhe me Vendimin V_864_2016 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri më 11 nëntor 2016, ne pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 06.11.2017 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizim Final V_660_2014, të datës 11 nëntor 2014, i vazhduar me Vendimin V_864_2016, të datës 25 nëntor 2016, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, për një afat shtesë **për vazhdimin e periudhës së ndërtimit edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, gjegjësisht deri me 11 nëntor 2018.**



- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., dhe me Vendimin V_932_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014 edhe për dymbëdhjetë (12) muaj, gjegjësisht deri më 11 nëntor 2018, ne pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 02.11.2018 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizim Final V_660_2014, të datës 11 nëntor 2014, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, për një afat shtesë **për finalizimin e ndërtimit të Hidrocentralit edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, gjegjësisht deri me 11 nëntor 2019.**
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: *arsyet pse janë detyruar të parashtrorjnë kërkesë për zgjatje të afatit, janë për shkak të pengesave të cilat u janë shfaqur jashtë kontrollit të kompanisë e të cilat kanë ndikuar në ndërtimin e këtij hidrocentrali.*
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka sqaruar se *projekti HC Vica për gati dy vite që nga lëshimi i Autorizimit Final, nuk ka mundur të vazhdon me realizimin e projektit, për shkak se kanë hasur në pengesa nga komuniteti i asaj zone edhe përkundër se janë organizuar debate publike me qëllim të informimit në lidhje me projektin, dhe në momentin kur është filluar me realizimin e punimeve janë organizuar protesta që patën penguar në dinamikën e realizimit të punimeve.*
- Poashtu ka sqaruar se *pengesa janë paraqitur në atë kohë edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjegjësisht nga Inspektorati i Ndërtimit, i cili në bazë të ankesave të paraqitura ka sjellë urdhjes për ndërprerjen e punimeve e të cilat kanë zgjatur deri me 10 nëntor 2016, pra për dy vite aq edhe sa ka qenë i ledhuar Autorizimi Final nga ZRRE.*
- Gjithashtu ka theksuar se *gjatë asaj kohe janë ndërmarr të gjitha veprimet për të cilat kanë bërë ankesa pran organeve Kompetente Komunale dhe në Ministrinë e Mjedisit, ku Ministria e Mjedisit në shtator të vitit 2015 ka lëshuar njoftimin me të cilën është lejuar vazhdimi i punëve ndërtimore. Edhe përkundër njoftimit nga Ministria përgjegjëse e cila kishte lejuar vazhdimin e punimeve është dashur të pritet edhe konfirmimi nga Komuna e Shtërpcës, e cila ka lëshuar Lejen ndërtimore, eci laka kërkuar që të vazhdohet sipas udhëzimeve të Komunës.*
- Nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e komunës së Shtërpcës me datë 10 nëntor 2016, pas analizimit të situatës rreth realizimit të projektit të Hidrocentralit HC Vica, është lëshuar njoftimi për ZRRE, ku është njoftuar se punimet në realizimin e projektit HC Vica, janë ndërprerë nga komuna që nga viti 2015 pasi që ka pasur paqartësi tek banorët lokal të cilit kanë paraqitur pengesa në fillimin e punimeve, dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ZRRE-së, që të merret parasysh situata e krijuar përgjatë kësaj periudhe kohore në mënyrë që të mund të rivendosen afatet e përcaktuara për investitorin. Poashtu ka kërkuar edhe mirëkuptimin e investitorit për humbjen e kohës, në realizimin e projektit dhe që pas kësaj janë krijuar kushtet e përshtatshme për rifillimin e punimeve, me shpresë se janë tejkaluar paqartësitë rreth këtij projekti.
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., me datë 10.11.2016 ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final edhe për një vit, për ndërtimin e hidrocentralit HC Vica, ZK Drekoc Komuna e Shtërpcës. Nga Bordi i ZRRE-së, me datë 25 nëntor 2016 është lëshuar Vendimi V_864_2016 me të cilën është aprovuar shtyrja e afatit për ndërtimin e Hidrocentralit edhe për një vit, edhe pse është shpresuar se kërkesa do të aprovohet për dy



vite, pasi që periodha e lejuar me Autorizimin final, nuk ka mundur të përmbushet për shkak të pengesave që kanë qenë jashtë kontrollit të kompanisë nga persona të caktuar.

- Poashtu ka sqaruar se në lidhje me verifikimin e këtyre punimeve pas krijimit të kushteve për ndërtimin e këtij hidrocentrali me datë 19 tetor 2017 Inspektorati i Ambientin ka qenë në vend-punishite, ku janë duke u kryer punimet nga kompania, dhe është verifikuar se projekti HC Vica dhe projektet tjera q janë duke u realizuar nga kompania Matkos Group SH.P.K., janë në zhvillim e sipër, sipas dinamikës së punimeve dhe kushteve ligjore dhe kanë theksuar se ka progres të dukshëm, për të cilën gjeni të bashkangjitur edhe procesverbalin nr. 17 –ins P-30-vs- 12 mbi Inspektimin e Punimeve nga Ministria e Ambientit.
- Poashtu në pamundësi të realizimit të projektit brenda vitit 2017 me datë 06.11.2017 është parashtruar kërkesa për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final edhe për një vit, duke paraqitur edhe arsyeshmërinë e mos mundësisë së ndërtimit, brenda kësaj periudhe të këtij Hidrocentrali, duke sqaruar se, është bërë progres i dukshëm në ndërtimin e HC Vica, ku janë kryer punë ndërtimore, edhe përkundër faktit se është filluar me vonesë për më shumë se 2 vite pas lëshimit të Autorizimit Final, për shkak të pengesave të cilat u paraqitën më lart.
- Poashtu ka theksuar se, duke marr parasysh faktin dhe natyrën komplekse të projekteve në fushën e hidrocentraleve dhe pengesat e prezetuara më lartë, ka qenë e pamundur që të përfundohet ky projekt brenda këtij afati, duke parë edhe natyrën komplekse në ndërtimin e hidrocentraleve të cilat janë duke u ndërtuar kryesisht në terrene shumë të vështira, jemi detyruar që të parashtrojmë kërkesë për zgjatje, edhe pse do të dëshironim të përfundojmë sa më shpejt, pasi që jem në obligime financiare dhe për çdo vonesë shkaktohen humbje financiare.
- Shoqëria Matkos Group SH.P.K., që nga pranvera e këtij viti, pasi që janë mundësuar kushtet klimatike, ka punuar intesivisht në terren edhe përkundër vështirësive dhe gjatë muajve të verës të reshjeve atmosferike që kanë mbretëruar në Kosovës, ku shpesh herë është dashur të ndalohen punimet në teren, dhe deri më tani ka përfunduar më shumë se 80 % të punimeve, ku ka përfunduar veprën e marrjes, janë shtruar më shumë se 4 km tubacion dhe është duke u punuar intesivisht në godinën e hidrocentralit, janë blerë edhe turbinat dhe pajisjet përcjellëse, poashtu është duke u punuar edhe në largpërçuesin sipas pëlqimit elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS.
- Andaj, duke marr parasysh faktin se afati kohorë i dhënë me Autorizim Final dhe me vendimet për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_660_2014, për ndërtimin e hidrocentralit HC Vica, nuk mund të arrihet të përfundohet, dhe për të qenë në harmoni me legjislacionin e ZRRE-së, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 16 par. 5 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja Bazuar në BRE, jemi detyruar që të parashtrojmë kërkesën për zgjatje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final edhe për një afat shtesë, mundësisht edhe për një vit, ku shpresojnë se mund të përfundojmë finalizimin e këtij projekti me rëndësi në Kosovës, kur dihet se ky projekt dhe projektet tjera janë të rëndësishme në arritjen e caqeve të BRE-ve, dhe investimet private janë shtyllë e zhvillimit ekonomik në Kosovë, pasi që pengesat në realizimin e këtij hidrocentrali, brenda këtyre afateve, kanë qenë jashtë kontrollit të kompanisë Matkos Group SH.P.K., pasi që edhe plani dinamik fillestar nuk ka mundur të zbatohet për arsyet dhe dëshmitë e paraqitura më lartë, poashtu duke parë që janë realizuar më shumë se 80 % e punimeve në teren, shpresojmë se edhe zgjatja e afatit të autorizimit final prej një viti do të ishte e mjaftueshme për finalizimin e këtij projekti.



- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K. dhe dëshmime të bashkangjitura për zgjatje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, në Komunën e Shtërpcës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se për shkak pengesave të paraqitura jashtë kontrollit së investitorit dhe të kompleksitetit të ndërtimit të Hidrocentraleve, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014, do të vlen deri me datë **11 nëntor 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janoya, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.